



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 45/18 Prot.

Tiranë më, 12/11/2024

V E N D I M

Nr. 56, datë 12.11.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Enton Radovani Kryesues
Henri Naqellari Relator
Edona Dushaj Anëtare

në datën 12.11.2024, në orën 10:00, në ambientet e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT:

Z. Ndriçim Zenel Koka, me funksion aktual: Asistent, në Zyrën Ndihmëse, në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

OBJEKTI:

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, (këtu e në vijim Ligji nr. 12/2018, i ndryshuar).

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoji dhe vlerësoi shpjegimet dhe argumentimin ligjor të relatorit të çështjes, Z. Henri Naqellari, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi, bazuar në Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.
2. Në zbatim të nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore vlerëson punonjësit në pozicionet e mëposhtme:
 - a) *Drejtor dhe Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm, Drejtor Departamenti, Drejtor i Drejtorisë Qendrore, Drejtor në strukturat e veçanta, Drejtor e Zëvendësdrejtor vendor, Drejtor në Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit, Shef Komisariati, Shef Sektori në nivel qendror e vendor, që mbulon fushën e krimit të organizuar, krimit ekonomik/financiar dhe policisë rrugore në Policinë e Shtetit;*
 - b) *Drejtor dhe Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm, Drejtor Drejtorie dhe Shef Njësie në Gardën e Republikës;*
 - c) *Drejtor dhe Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm, Drejtor Drejtorie, Shef Sektori në nivel qendror dhe vendor në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore;*
 - d) *punonjësit që do të emërohen në strukturën e vlerësimit kalimtar/periodik në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore;*
 - e) *çdo punonjës që emërohet në pozicionet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “d”.*
3. Sipas përcaktimeve të nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, Z. Ndrçim Koka ka qenë subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij si Zëvendësdrejtor për Sigurinë Publike, në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
4. Subjekti i vlerësimit, Z. Ndrçim Koka, i'u nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datën 04.07.2023, nga Trupat e Vlerësimit, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7, datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”. Sipas shortit të zhvilluar, si Trupë Vlerësuese u zgjodh Z. Enton Radovani (Kryesues), Znj. Kleada Mersinllari (Relatore) dhe Znj. Edona Dushaj (Anëtare).
5. Subjekti i vlerësimit, Z. Ndrçim Koka, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë, deklaratën e kontrollit të figurës dhe formularin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 2, nenit 36, pika 1, dhe nenit 44, pika 1, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, të cilat janë marrë në dorëzim nga relatori i çështjes.

6. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me Vendimin nr. 1, datë 24.07.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
7. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”, me Vendimin nr. 1, datë 24.07.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Ndrichim Koka.
8. Relatori i çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 25.07.2023, njoftoi subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, duke i bërë me dije përbërjen e Trupës së Vlerësimit dhe duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
9. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në datën 27.07.2023, duke u shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
10. Relatori i çështjes në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, dhe sipas:
 - nenit 7, pika 1, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023 “Për hapat proceduralë të unifikuar”, nenit 4 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (këtu e në vijim ILDKPKI), ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 25.07.2023, pranë ILDKPKI-së, formularin e deklaramit të pasurisë për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
 - nenit 7, pika 4, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023 “Për hapat proceduralë të unifikuar”, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 25.07.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, deklaratën e kontrollit të figurës për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
 - nenit 7, pika 7, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023 “Për hapat proceduralë të unifikuar”, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 25.07.2023, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, formularin e aftësive profesionale për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
11. ILDKPKI, me shkresë nr. ***, prot., datë 08.04.2024, dërgoi raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të vlerësimit Z. Ndrichim Koka, në përputhje me nenin 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
12. Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, me shkresë nr. ***, prot., datë 03.01.2024, dërgoi raportin e kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit Z. Ndrichim Koka, në përputhje me nenin 42, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

13. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresë nr. ***, prot., datë 01.09.2023, dërgoi raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e vlerësimit Z. Ndriçim Koka, në përputhje me nenin 46, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
14. Në vijim relatori i çështjes, bazuar në nenin 34, nenin 42 dhe nenin 46 të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet përgjegjëse, duke filluar një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.
15. Hetimi administrativ përfshin edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur, në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5, i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.
16. Gjatë procesit të vlerësimit, relatori i çështjes ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, dhe në këto kushte është zëvendësuar me anëtarin e Trupës së Vlerësimit Z. Henri Naqellari, sipas shortit të zhvilluar më datë 04.07.2023, për caktimin e anëtarit zëvendësues.
17. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit ndërmjet anëtarit zëvendësues të Trupës së Vlerësimit dhe subjektit të vlerësimit.
18. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresë nr. ***, prot., datë 11.10.2024, ka njoftuar Trupën e Vlerësimit, se subjekti i vlerësimit Z. Ndriçim Koka, është transferuar dhe emëruar me detyrë Asistent, në Zyrën Ndihmëse, në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
19. Trupa e Vlerësimit është vënë në dijeni të urdhrit të transferimit dhe emërimit të subjektit të vlerësimit, në një detyrë që nuk parashikohet në nenin 6, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, në kushtet kur nuk kishte marrë vendim përfundimtar për përfundimin e hetimit administrativ.

II. ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT

20. Trupa e Vlerësimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, administroi dokumentacionin si vijon:
 - *Urdhër nr. 5249, datë 07.10.2024, “Për transferimin dhe emërimin në detyrë të punonjësit të policisë Kryekomisar Ndriçim Zenel Koka”.*
21. Nga verifikimi i akteve në tërësi në këtë fazë të hetimit, Trupa e Vlerësimit konstaton se, subjekti i vlerësimit është emëruar në detyrën Asistent, në Zyrën Ndihmëse, në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Shtetit, nr. 5249, datë 07.10.2024.

22. Sa më sipër Z. Ndriçim Koka:

- *Nuk është subjekt i vlerësimit kalimtar, për shkak të pozicionit të tij të punës jashtë fushës së ushtrimit të veprimtarisë së institucionit të vlerësimit kalimtar (Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore), pozicion që nuk përcaktohet në pikën 1, të nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.*

23. Në këto kushte, Trupa e Vlerësimit deklaroi të përfunduar çështjen e hetimit administrativ të nisur ndaj subjektit të vlerësimit, pa një vendim përfundimtar për shkak se interesi, qëllimi dhe objekti për të cilin ka nisur procedura, janë bërë ligjërisht të pamundur, duke konstatuar se ndodhemi në kushtet e zbatimit të nenit 95, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, mbështetur në Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;

V E N D O S I:

1. Ndërprerjen e procesit të vlerësimit kalimtar të subjektit të vlerësimit **Z. Ndriçim Zenel Koka**, me funksion aktual Asistent, në Zyrën Ndihmëse, në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pa një vendim përfundimtar.
2. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi brenda 45 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Ky vendim u shpall sot më datë 12.11.2024, në Tiranë.

TRUPA E VLERËSIMIT

Enton RADOVANI

Kryesues

Henri NAQELLARI

Relator

Edona DUSHAJ

Anëtare